

Njoftim

Mbi rezultatet perfundimtare të tenderit për Blerjen e Energjisë Lidhur me Mbulimin e Humbjeve në Rrjetin e Transmetimit.

- Data dhe Orari i pranimit të ofertave (Open Entering of Tender Bids 10 am).

- Data dhe Orari i mbylljes së pranimit të ofertave (Close Entering of Tender Bids 12 pm).

- Vlerësimi I tenderit nga platforma (Automatically evaluate tender 12 pm – 12:30 pm).

- Publikimi i rezultateve paraprake të tenderit (Automatically publish tender results 12:30 pm).

- Publikimi I rezultateve perfundimtare 13:30 pm.

Pas Vlerësimit të rezultateve paraprake të tenderit, u konstatua se pjesëmarrës në këtë procedurë, ishin 4 Subjekte Tregtare të ndryshëm si më poshtë vijon:

1. Gen – i Tirana sh.p.k
2. Noa Energy Trade sh.p.k
3. Future Energy Trading.p.k
4. GSA sh.p.k

Të kualifikuar:

1. GSA sh.p.k, i cili ka paraqitur ofertë të vlefshme, duke plotësuar kriteret e përcaktuara.

Të skualifikuar:

1. Gen-i Tirana i skualifikuar për arsye se nuk ka përmbushur kriterin e ofertës vjetore;
2. Future Energy Trading sh.p.k i skualifikuar për arsye se nuk ka plotësuar kriterin e ofertës vjetore;
3. Noa Energy Trade sh.p.k, i skualifikuar për arsye se nuk ka përmbushur kriterin e ofertës vjetore.

Në këto kushte, Procedura e Blerjes së Energjisë së Humbjeve në Rrjetin e Transmetimit, e caktuar në datë 18/12/2017, do të përsëritet si pasojë e mosplotësimit të numrit minimal prej 3 ofertuesish të përcaktuar në nenin 15, të Vendimit nr. 103, datë 23.06.2016 të ERE, mbi “Miratimin e Rregullores për procedurat e blerjes së Energjisë Elektrike për Mbulimin e Humbjeve në Rrjetet e Shpërndarjes dhe të Transmetimit dhe për Blerjen dhe shitjen e Energjisë Elektrike për të Siguruar Përmbushjen e Detyrimeve të Shërbimit Publik”, i cili përcakton se:

15.1 Në rastin kur më pak se tre tregtare kanë paraqitur ofertat, procesi do të përsëritet.

15.2. Kur rishikimi, vlerësimi dhe krahasimi nga Blerësi nuk është i mundur për shkak të formatit të informacionit të ofertës dhe/ose kur informacioni kërkon sqarim nga ofertuesi, oferta skualifikohet. Nëse numri i ofertave pas skualifikimeve të mundshme është më poshtë se tre, procesi do të përsëritet serish.

Data e përsëritjes së tenderit do te publikohet ne Kalendarin e Ofertave ne website www.ost.al